



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit me numër 24-652/1, të datës 10.07.2024 për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës, me titull *“Ndikimi i zbatimit të mësimit të diferencuar tek suksesi i nxënësve në shkollën fillore”*, të kandidatës Mr.sc.Digjle Namligji, komisioni në përbërje: Prof.dr. Lulzim Mehmedi-kryetar, Prof. dr. Fadbi Osmani-anëtar, Prof. dr. Besa Havziu Ismaili-anëtar, Prof. dr.Valdeta Zenuni Idrizi-anëtar dhe Prof.dr.Jehona Rushidi- Rexhepi-anëtar, pasi e lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Pedagogjik i paraqet këtë

R A P O R T

për vlerësimin e disertacionit të doktoratës

Punimi i disertacionit të doktoratës së kandidatës **Digjle Namligji** i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoratës, si në aspekt strukturor po ashtu edhe në aspekt përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor.

Lënda e hulumtimit:

Mësimi i diferencuar është një qasje pedagogjike që synon ta përshtasë procesin e mësimdhënies për t'iu përgjigjur nevojave individuale të çdo nxënësi. Në këtë qasje, mësuesit modifikojnë metodat e tyre të mësimdhënies, përmbajtjen, procesin dhe produktin e mësimit, për të siguruar që çdo nxënës të marrë mbështetjen dhe sfidat e duhura bazuar në stilin e të mësuarit, aftësitë dhe interesat e tyre. Zbatimi i mësimit të diferencuar në shkollën fillore ka një ndikim të rëndësishëm në suksesin akademik dhe personal të nxënësve. Kjo qasje, duke u përshtatur me nevojat dhe stilin e të mësuarit të secilit nxënës, ndihmon që secili të përparojë në mënyrë optimale. Disa nga ndikimet kryesore të kësaj metode përfshijnë:

1. Rritje të motivimit dhe përfshirjes në mësim

Mësimi i diferencuar u jep nxënësve mundësinë të punojnë me materiale dhe detyra që përputhen me interesat dhe aftësitë e tyre. Kjo përfshirje aktive në procesin e mësimin rrit motivimin e tyre për të përparuar. Nxënësit janë më të angazhuar kur detyrat janë të përshtatshme për nivelin e tyre të zhvillimit dhe interesave.

2. Përmirësim të arritjeve akademike

Duke u përshtatur me aftësitë individuale, mësimi i diferencuar ndihmon nxënësit të përvetësojnë më mirë materialin mësimor. Nxënësit më të avancuar sfidohen më shumë, ndërsa ata që kanë vështirësi marrin mbështetje të personalizuar, duke përmirësuar kështu arritjet e tyre akademike.

3. Rritje të vetëbesimit dhe autonomisë

Kur nxënësit përballen me detyra që janë në nivelin e tyre dhe arrijnë t'i përfundojnë me sukses, kjo forcon vetëbesimin e tyre. Ata ndihen më të aftë dhe më të pavarur në mësim, pasi përjetojnë përparim të qartë në mësimdhënie.

4. Zhvillim të aftësive sociale dhe bashkëpunimit

Në mësimin e diferencuar, shpesh nxënësit punojnë në grupe të vogla, ku detyrat përshtaten me nivelin e tyre individual. Ky bashkëpunim i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe punë në grup, që janë të rëndësishme për suksesin e tyre në të ardhmen.

5. Mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit me vështirësi mësimore apo nevoja të veçanta përfitojnë veçanërisht nga mësimi i diferencuar, pasi kjo metodë u siguron atyre qasje të personalizuar dhe ndihmë të vazhdueshme për t'i përmbushur objektivat e tyre.

Karakteristikat kryesore të mësimin të diferencuar përfshijnë:

1. Përdorim të metodave të ndryshme mësimore: Mësuesit përdorin strategji të ndryshme për të shpjeguar përmbajtjen e lëndës, si p.sh. mësim në grupe të vogla, projekte ose detyra individuale.
2. Përshtatje të materialeve të mësimin: Materialet mund të jenë të ndryshme për nxënësit në varësi të nevojave të tyre, për shembull libra me nivele të ndryshme të vështirësisë ose burime digjitale që i përshtaten interesave të tyre.
3. Vlerësim të vazhdueshëm: Nxënësit monitorohen dhe vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme për të identifikuar pikat e forta dhe nevojat për përmirësim, gjë që ndihmon në krijimin e planeve të personalizuar të mësimin.

4. Përdorimin e stileve të ndryshme të mësimi: Mësimi i diferencuar njih dhe respekton se nxënësit mësojnë në mënyra të ndryshme, disa preferojnë të mësojnë nëpërmjet pamjeve vizuale, të tjerët nëpërmjet dëgjimit ose përvojave praktike, etj.

Duke u bazuar në rëndësinë e zbatimit të mësimi të diferencuar në shkollat fillore, mësimi i cili dukshëm krijon një ambient më përfshirës, ku çdo nxënës ka mundësi të përparojë sipas ritmit të vet, duke ndikuar pozitivisht në rezultatet akademike dhe zhvillimin e tij të përgjithshëm, si lëndë hulumtimi në këtë disertacion kemi ndikimin e mësimi të diferencuar në suksesin e nxënësve në arsimin fillor.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i mësimi të diferencuar është të sigurohet që çdo nxënës të përparojë në mënyrë optimale dhe të ketë sukses sipas ritmit dhe stilit të tij të të mësuarit. Ndërsa qëllimi kryesor i këtij studimi shkencor është të analizojë, përshkruajë dhe të krahasojë gjendjen aktuale rreth zbatueshmërisë së mësimi të diferencuar si dhe ndikimin e këtij lloji të mësimi në ngritjen e suksesit të nxënësve në shkollën fillore të qytetit të Prizrenit me rrethinë, duke na mundësuar marrjen e përgjigjes në pyetjen e hulumtimit: „A ndikon diferencimi i mësimi në përmirësimin e suksesit të nxënësve në shkollat fillore?“.

Bazuar në rishikimin e literaturës së këtij punimi dhe studimeve të ngjashme të prezantuara në punim, për çdo qëllim dhe pyetje kërkimore është paraqitur një hipotezë gjenerale dhe tetë hipoteza ndihmëse. Si hipotezë themelore nga e cila është nisur kandidatja në punim supozohet se:

- *Zbatimi i mësimi të diferencuar në mësimdhënle ndikon në rritjen e suksesit të nxënësve gjatë procesit mësimor.*
- Nga hipoteza gjenerale burojnë këto hipoteza ndihmëse:
- Respektimi i dallimeve individuale ndikon në ngritjen e suksesit të nxënësve.
- Diferencimi në procesin mësimor është kërkesë e rëndësishme në identifikimin e dallimeve individuale.
- Përzgjedhja e teknikave interaktive ndihmon në motivimin e nxënësve gjatë mësimi të diferencuar.
- Të nxënit e diferencuar ndikon në rritjen e interaktivitetit të nxënësve gjatë orës mësimore.

- Definimi i inteligjencave të shumëfishta ndikon në qasjen e mësimdhënësve me llojin e metodologjisë së mësimdhënies.
- Identifikimi i stileve të të nxënësve ndihmon në të nxënësve gjatë orës mësimore.
- Komunikimi efektiv me prindër ndikon në zbatimin e mirëfilltë të mësimin të diferencuar.
- Përdorimi i mjeteve teknologjike të konkretizimit ndikon në të nxënësve gjatë orës mësimore si dhe ndikon në rritjen e suksesit në mësimnxënie.

Struktura e këtij disertacioni të doktoraturës është organizuar në pjesën hyrëse e cila ngërthen në vete fushën shkencore të studimit, argumentet pse u ndërmorr studimi, përshkruhet problemi dhe rëndësia e studimit; ndërsa pesë kapitujt përfshijnë: qasjen teorike të problemit të hulumtimit; metodologjinë e studimit; gjetjet e hulumtimit, diskutimet, përfundimin dhe rekomandimet, të cilët japin mjaft dëshmi mbi problemin e parashtruar dhe dëshmojnë se mësimi i diferencuar ndikon në ngritjen e suksesit të nxënësve në shkollat fillore. Punimi i disertacionit përfshin 118 tabela dhe 13 figura që pasqyrojnë pjesën teorike.

Në kapitullin e parë është përshkruar trajtimi teorik i problemit të hulumtimit të gjendjes aktuale rreth zbatimit të mësimin të diferencuar në shkollat urbane dhe rurale të qytetit të Prizrenit, përcaktimi i terminologjisë së mësimin të diferencuar gjatë procesit mësimor. Janë definuar nevoja dhe rëndësia e realizimit të këtij hulumtimi në Republikën e Kosovës si dhe janë përcaktuar kriteret etike të këtij studimi.

Në kapitullin e dytë është bërë përkufizimi teorik i të mësuarit në gjuhën amtare në përgjithësi duke analizuar aspektet teorike të zhvillimit dhe realizimit të gjuhës shqipe si kompetencë kurrikulare, rëndësia e të nxënësve në gjuhën shqipe tek arsimit fillor, po ashtu janë përmendur edhe aspektet metodologjike të mësimdhënies së *Gjuhës shqipe* në klasat e ulëta. Në këtë kontekst, është theksuar nevoja e diferencimit në mësimdhënie gjatë arsimimit fillor. Në këtë kapitull janë trajtuar qasjet e diferencuara të mësimdhënies, teoritë kryesore dhe operacionalizimi i mësimin të diferencuar. Janë definuar strategjitë e shumëfishta si dhe teknikat e mësimin të diferencuar në të nxënësve gjatë mësimin të diferencuar. Duke u bazuar në konceptin se mësimi i diferencuar buron nga mësimi i individualizuar, gjatë këtij kapitulli është bërë një vështrim teorik i këtij lloji të mësimin duke dhënë shembuj të planit individual. Është definuar po ashtu rëndësia e vlerësimit të njohurive të nxënësve si proces mjaft i rëndësishëm gjatë të nxënësve të diferencuar. Është vënë në pah roli i nxënësve si faktor i rëndësishëm gjatë procesit mësimor.

Në vazhdim është përshkruar procesi i funksionimit të motivimit dhe inkurajimit të nxënësve në klasë. Është bërë definimi i inteligjencave të shumëfishta si dhe llojeve të stileve të të nxënësve në shkollat fillore si dhe ndikimi i këtyre koncepteve në të nxënësve e diferencuar; roli, rëndësia, atmosfera pozitive dhe karakteristikat e mjedisit klasor në zbatimin e diferencimit; përshkrimi i procesit të planifikimit gjatë diferencimit në mësimdhënie, mësimin të diferencuar në veçanti në shkollat fillore. Po ashtu, është dhënë edhe përshkrim teorik rreth ndikimit të mësimin të diferencuar si faktor në rritjen e suksesit të nxënësve gjatë procesit mësimor.

Në kapitullin e tretë trajtohet pjesa e metodologjisë së hulumtimit duke përfshirë dizajnimin dhe identifikimin e fushës problemore gjatë hulumtimit, mbledhja, analiza dhe interpretimi i të dhënave, realizimi i planit të veprimit duke përfshirë qëllimin e studimit, objektin e hulumtimit, problemin e studimit, pyetjet e hulumtimit, detyrat e hulumtimit, përkufizimi konceptual i variablave, hipotezat e hulumtimit. Po ashtu, janë definuar instrumentet matëse të hulumtimit, është përshkruar popullata e targetuar dhe përzgjedhja e kampionit. Në këtë kapitull është përshkruar mënyra e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave sipas programit statistikor SPSS, limitet e studimit, burimet e referuara dhe metodat e hulumtimit shkencor.

Në kapitullin e katërt është realizuar analiza dhe verifikimi statistikor i gjetjeve të fituara nga subjektet e hulumtimit (nxënës, mësimdhënës, prindër dhe drejtorë të shkollave), analiza dhe krahasimi i gjetjeve gjatë para-testit dhe pas-testit me nxënës në klasat tradicionale dhe të diferencuara. Paraqitja e rezultateve përfundimtare në fakt përmbledh gjetjet më të rëndësishme të studimit sasior dhe cilësor krahasuar me gjetjet nga studime të ngjajshme që kanë trajtuar këtë problem. Në fund është bërë edhe verifikimi i hipotezave.

Kapitulli i pestë *Përfundime dhe rekomandime*, paraqet në mënyrë të sintetizuar përfundimet kryesore të këtij punimi si dhe jep rekomandime të mbledhura nga gjetjet empirike të studimit, analiza e literaturës dhe burimet dytësore, ku studimi na mundëson të shtrijmë të menduarit rreth sugjerimeve për kërkime të mëtejshme me faktorë të tjerë që nuk kanë qenë pjesë e këtij studimi.

Seksioni i *Bibliografisë*, përmban burimet e literaturës, të cilat janë përdorur për shtjellimin teorik të këtij studimi.

Në fund, *Shtojcat*, përmbledhin instrumentet e përdorura për hulumtimin sasior dhe cilësor.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Gjatë hartimit të këtij punimi të doktoratës me titull "*Ndikimi i zbatimit të mësimin të diferencuar tek suksesi i nxënësve në shkollën fillore*" kandidatja i është përmbytur respektimit të standardeve metodologjike në punën e saj kërkimore-shkencore.

Metodologjia e përdorur në këtë disertacion është e zhvilluar në disa faza dhe mbështetet në studime cilësore dhe sasiore, ndërsa për mbledhjen e të dhënave janë përdorur disa instrumente si: Intervistë e strukturuar me drejtorë, Protokoli i vëzhgimit të nivelit të zbatueshmërisë së mësimin të diferencuar nëpër shkollat fillore, Formular i vlerësimit të paratestit dhe pastestit, Pyetësor për mësimdhënës, Lista e kontrollit rreth inteligjencave të shumëfishta të nxënësve, Lista e kontrollit të nxënësve bazuar në aktivitete të realizuara në lëndën e Gjuhës shqipe, Lista e kontrollit të performancës së nxënësve gjatë lojës skenike, Pyetësor për nxënës, Formular i vlerësimit të paratestit dhe pastestit, Pyetësor për prindër.

Në aspektin metodologjik mbledhja e të dhënave gjatë këtij punimi është realizuar nëpërmjet hulumtimit në veprim. Hulumtimi në veprim paraqet metodën e hulumtimit përmes së cilës hulumtuesi (mësimdhënësi/ja) ndërmerret disa veprime për të zgjidhur një problem. Përveç kësaj, mësimdhënësit e përdorin për t'i përmirësuar praktikën e tyre të mësimdhënies.

Hulumtimi në veprim paraqet kërkimin sistematik që fillon me një pyetje dhe kërkon një planifikim shumë të mirë para se të fillojmë mbledhjen e të dhënave. Tregon fleksibilitet dhe shumëllojshmëri në mbledhjen e të dhënave, analizën dhe raportimin e tyre. Kërkon vëzhgime të rregullta dhe nuk ka nevojë të provojë asgjë. Hulumtimi në veprim fillon me përcaktimin e një situatë problemore që do të hetohet ose një dimension që duhet të shqyrtohet në procesin e zbatimit. Gjatë identifikimit të fushës problemore ekzistojnë disa probleme që duhet të merren parasysh dhe të fokusohen në atë drejtim. Prandaj, fusha e përqendrimit duhet të jetë te:

- Lënda ku mund të arrihet kontrolli,
- Në një lëndë që dëshirohet të ndryshohet ose përmirësohet qasja e mësimdhënies,
- Përfshirja e aktiviteteve të ndryshme të përshtatshme me lëndën.

Zhvillimi i aftësive gjuhësore zë një vend të rëndësishëm në komunikimin e nxënësve, në përfitim të njohurive të reja dhe përmirësimin e tyre në të gjitha aspektet, për të fituar dhe përvetësuar njohuritë dhe aftësitë gjuhësore në lëndën e Gjuhës shqipe si, p.sh: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, prezantimit vizuel etj. Mësimi bashkëkohor duhet të ofrojë një

proces mësimor që është i ndjeshëm ndaj dallimeve individuale të nxënëve në klasë. Për ta arritur këtë rekomandohet përdorimi i metodave dhe i teknikave të reja në mësimdhënie.

Hulumtimi i kandidatës është i karakterit të hulumtimit në veprim, prandaj për realizimin e planifikimit të hulumtimit, paraprakisht është marrë pëlqimi nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren për realizimin e hulumtimit në fjalë. Ky hulumtim fokusohet të analizojë nivelin e zbatueshmërisë së mësimit të diferencuar si dhe ndikimin e zbatimit të kësaj metodologjie te suksemi i nxënësve në shkollat fillore të qytetit të Prizrenit si dhe në disa fshatra përreth tij. Gjatë realizimit të hulumtimit janë mbledhur të dhëna rreth numrit të nxënësve dhe të klasave nëpër shkollat kampionë. Është realizuar vëzhgimi i grupeve të kontrollit gjatë realizimit të hulumtimit, janë identifikuar stilet e të nxënësve dhe inteligjencat e shumëfishta në fushat dominuese. Në bashkëpunim me mësueset/it e klasave të përzgjedhura janë hartuar plane bashkëkohore ku përfshihen elemente të diferencuara të mësimdhënies si dhe plane tradicionale për të pasur mundësi krahasimi të qasjet mësimore.

Procesi i hulumtimit është realizuar gjatë periudhës kohore prej 01.02.2023 dhe ka përfunduar më 31.06.2023, pra në një periudhë kohore gjashtëmujore. Hulumtimi është realizuar me kohëzgjatje një javore në secilën shkollë. Procesi i planifikimit të hulumtimit është paraqitur në një tabelar ku janë përshkruar pesë ditët e realizuara në shkollat fillore (në tabelar janë përfshirë ditët, aktivitetet si: intervista me drejtorin e shkollës, përzgjedhja e klasave tradicionale dhe të diferencuara, njohja me mësimdhënësit pjesëmarrës, njohja me nxënësit, vëzhgimi i realizimit të procesit mësimor në klasat e përzgjedhura, shpërndarja e pyetësorëve për nxënësit dhe prindërit, realizimi i para testit dhe pas testit si dhe kohëzgjatja e aktiviteteve).

Përpunimi dhe analizimi i të dhënave sasiore të përmbledhura nga anketimi janë referuar analizës deskriptive - përshkruese dhe përpunimit të dhënave duke përdorur programin SPSS (Social Package for the Social Science). Fillimisht është përdorur statistika deskriptive për t'i paraqitur të dhënat demografike të respondentëve të hulumtimit e më pas statistika inferenciale (testet e përdorura) për t'i analizuar marrëdhëniet në mes të variablave. Ndërsa, gjatë analizës së të dhënave cilësore të përfituara nga intervista me drejtorët e shkollave, kandidatja ka përdorur metodën e analizës përmbajtësore. Sa i përket analizës së rezultateve të paratestit dhe pastestit të nxënësve të përfituara nga vlerësimi me shkrim të eseve të nxënësve, fillimisht është përdorur gjetja e mesatares dhe devijimit standard nga klasat tradicionale dhe të diferencuara.

Për t'i krahasuar dallimet në mes të dy mostrave të varura nga paratesti dhe pastesti të strukturës së shkrimit sipas klasave tradicionale dhe të diferencuar është përdorur t- testi. Ndërsa, për t'i parë dallimet e paratestit dhe pastestit sipas shkollave kampion është përdorur testi One - Way Anova. Gjatë analizës së të dhënave të mbledhura nga protokollet e vëzhgimit të zbatueshmërisë së mësimi të diferencuar si dhe në përcaktimin e nivelit të zbatimit të mësimi të diferencuar në klasat tradicionale dhe të diferencuara janë përdorur statistikat përshkruese (të përqindjes dhe frekuencës). Testimi i dallimeve në ambientin e klasës sipas shkollave të vëzhguara është zbatuar Testi Kruskal – Wallis si alternativë e analizës One – Way- ANOVA, duke pasur parasysh se variablat e këtij protokoli janë vlerësuar duke përdorur shkallën nominale.

Gjatë përpunimit të të dhënave nga anketimi i mësimitdhënësve kandidatja përdor statistikat përshkruese (frekuencat dhe përqindjet, vlerën minimale, maksimale, mesataren dhe devijimin standard) në lidhje me respondetët e hulumtimit. Gjatë testimit të dallimeve në zbatimin e mësimi të diferencuar sipas karakteristikave demografike të mësimitdhënësve është përdorur analiza ANOVA. Ndërsa, për të testuar nëse ekzistojnë dallime në zbatimin e mësimi të diferencuar sipas mësimitdhënësve që kanë ndjekur trajnime dhe atyre që nuk kanë ndjekur trajnime është përdorur Testi- t i dy mostrave të pavarura (Independent samples t-test).

Në përmbledhje, këto dëshmi të qarta dhe të shumta vërtetojnë që metodologjia e përdorur në këtë studim është e pasur dhe gjithëpërfshirëse, duke i ofruar disertacionit një pamje të plotë dhe të qëndrueshme.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Faza e analizës dhe interpretimit të të dhënave është faza më e rëndësishme e një hulumtimi shkencor. Kjo fazë paraqet përpjekjen në të cilën të dhënat e mbledhura nga hulumtuesi duhet të jenë të sakta, pra objektive dhe të besueshme. Gjatë hulumtimit, hulumtuesi identifikon temat dhe kategoritë gjatë mbledhjes dhe analizimit të dhënave. Në këtë mënyrë fitohet një pamje induktive-analitike. Duke qenë se analiza e të dhënave bëhet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme gjatë hulumtimit, ky proces i jep hulumtuesit një ide për cilësinë dhe përshtatshmërinë e të dhënave të përmendura gjatë hulumtimit. Gjatë këtij procesi është analizuar se sa zbatohet diferencimi i mësimitdhënies në shkollat fillore dhe sa ndikon te sukcesi i nxënësve kjo qasje mësimore. Janë vëzhguar klasat e pëzgjedhura si kampion i këtij hulumtimi. Janë planifikuar dy plane ditore për klasat e diferencuara dhe dy plane ditore për klasat

tradicionale në mënyrë që të analizohet dhe krahasohet ndikimi i qasjes së diferencuar të suksesi i nxënësve. Hartimi i këtyre planeve është bërë pasi janë diagnostifikuar sitlet e të nxënësve si dhe inteligjencat e shumfishta të nxënësve. Është vlerësuar suksesi i nxënësve gjatë aktiviteteve të planifikuara në grupe si: shkrim, lexim, komunikim dhe aktrim në lojën skenike. Grupet janë formuar pas identifikimit të inteligjencave të shumfishta të nxënësve si dhe janë përcaktuar aktivitetet për secilin grup. Varësisht prej numrit të nxënësve në klasë janë formuar tre deri në katër grupe. Njëri prej grupeve është grupi i leximit (me nxënës të cilët posedojnë inteligjencë linguistike – gjuhësore), grupi tjetër është grupi i komunikimit ku nxënësit janë përgjigjur pyetjeve të drejtuara rreth përmbajtjes së materialit të shpërndarë, grupi tjetër është grupi i aktrimit të lojës skenike në role dhe të shkruarit e eseve ku përfshihen të gjitha grupet.

Në bazë të rezultateve të fituara nga hulumtimi në veprim, kandidatja verifikon hipotezën themelore të parashtruar në fillim të hulumtimit të mbështetur në atë se: „Zbatimi i mësimit të diferencuar në mësimdhënie ndikon në rritjen e suksesit të nxënësve gjatë procesit mësimor”.

Hulumtimi i kryer në shkollat fillore është trajtuar si në aspektin teorik poashtu dhe në aspektin praktik me anë të së cilit kandidatja pasqyron gjetjet e mëparshme të studiuesve lidhur me temën e trajtuar, ndërsa në aspektin empirik analizon rezultatet e hulumtimit, hulumtim i cili kishte për qëllim të analizojë, përshkruajë dhe të krahasojë gjetjet aktuale rreth zbatimit të mësimit të diferencuar si dhe ndikimin e këtij lloji të mësimit në ngritjen e suksesit të nxënësve në shkollat fillore.

Duke u bazuar në rezultatet e fituara nga analiza e pyetësorëve të hulumtimit arrin t'i vërtetojë hipotezat e ngritura duke iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të hartuara gjatë përgatitjes së hulumtimit. Rezultatet e fituara nga hulumtimi i realizuar, të ndarë në dy pjesë si paratest dhe pastest, dëshmuuan dallime të konsiderueshme të mesatarja, përqindjet dhe devijimi standard i faktorëve të hulumtimit.

- Në bazë të të dhënave të përfituara nga protokoli i vëzhgimit të zbatueshmërisë së mësimit të diferencuar në shkollat respondentë është konstatuar se klasat ofrojnë higjienë dhe ndriçim të mjaftueshëm për mësimdhënie efektive në klasë. Po ashtu është konstatuar se vetëm 29.2% të mësimdhënësve punojnë në grupe dhe në klasat tjera dominon forma e punës në çifte apo dyshe.
- Gjatë analizës së formimit të grupeve është zbuluar se mësimdhënësit nuk kushtojnë rëndësi në identifikimin e stileve të të nxënësve, inteligjencave si dhe suksesit të nxënësve

gjatë formimit të grupeve, por grupet formohen sipas preferencës së nxënësve apo të mësimit të ndryshëm.

- Po ashtu është vërejtur se vetëm 50% të mësimit të ndryshëm ofrojnë materiale didaktike gjatë të nxënësve si dhe vetëm 20% të mësimit të ndryshëm përdorin mjete të konkretizimit elektronik (llaptop, projektor).
- Diferenca të suksesi të nxënësve theksohet gjatë interpretimit të lojës skenike (përrallës) në role. Në klasat e diferencuara ku gjatë prezantimit të përrallës u përdorën mjetet e konkretizimit të nxënësve treguan performancë të lartë gjatë interpretimit në role, ndërsa në klasat tradicionale ku nuk u përdorën mjetet e konkretizimit të nxënësve treguan performancë të nivelit të ulët gjatë interpretimit në role.
- Mësimi i ilustruar nëpërmjet videos kishte ndikim të lartë që nxënësve të vëzhgojnë, përceptojnë, mësojnë tekstin në role, të komentojnë përmbajtjen dhe porositë si dhe ta interpretojnë lojën skenike me sukses të lartë dhe rrjedhimisht ndikoi në rritjen e suksesit të nxënësve në mësimin interaktiv dhe efektiv. Kjo dëshmon se përzgjedhja e teknikave interaktive ndihmon në motivimin dhe rritjen e suksesit të nxënësve gjatë mësimin të diferencuar.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatës:

Konsiderojmë se kandidatja ka dhënë kontribut të duhur në analizën e detajuar në punimin e disertacionit dhe se ky punim shkencor do të kontribuojë në fushën e pedagogjisë, sepse eksploron në mënyrë të thelluar se mësimi i diferencuar ka ndikim pozitiv në suksesin e nxënësve, një aspekt ky i rëndësishëm për politikat arsimore dhe praktikën mësimore. Hulumtimi pasqyron sfidat aktuale me të cilat përballen shkollat dhe mësimdhënësit, si p.sh. mungesa e mjeteve konkretizuese dhe metodat e kufizuara të mësimdhënies, duke ofruar kështu një bazë të dhënash për të orientuar përmirësimet e mëtejshme. Rekomandimet e nxjerra nga ky hulumtim, përfshirë nevojën për trajnime dhe furnizime didaktike, janë bazë për hartimin e politikave arsimore që synojnë përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Në të njëjtën kohë ky hulumtim nxjerr në pah rëndësinë e përdorimit të mjeteve teknologjike dhe interaktive si mjet për rritjen e performancës së nxënësve, duke ofruar dëshmi të qarta për efektivitetin e tyre. Mes tjerash, studimi thekson se implementimi i mësimit të diferencuar është i domosdoshëm veçanërisht në arsimin fillor, ku zhvillimi socio-emocional dhe njohës i nxënësve është thelbësor. Këto elemente përfaqësojnë një kontribut të rëndësishëm shkencor dhe praktik për zhvillimin e edukimit, veçanërisht në kontekstin e arsimit fillor dhe të diferencuar.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Në bazë të përfundimeve të nxjerra nga studimi i realizuar nga kandidatja Mr.sc. Digjle Namligji me titull **“Ndikimi i zbatimit të mësimit të diferencuar tek sukse si i nxënësve në shkollën fillore”**, për studime të mëtejshme rekomandohet të bëhen hulumtime më të thelluara që do të përfshinin variabla të tjerë të cilat kanë qenë e pamundur të përfshihen në një studim të vetëm. Andaj, për studime të mëtejshme sugjerohet që të bëhet:

- Një studim krahasues që analizon teknikat e ndryshme të mësimdhënies së diferencuar, si: përdorimi i teknologjisë, grupimi i nxënësve sipas aftësive, apo stilit të të nxënies. Ky hulumtim mund të masë efektet e secilës metodë në rezultatet e nxënësve në fusha specifike.
- Ndikimi afatgjatë i mësimit të diferencuar në performancën akademike: Një studim që ndjek nxënësit për disa vite për të kuptuar se si mësimi i diferencuar ndikon në suksesin e tyre akademik në afat të gjatë, në veçanti në fazat e mëvonshme të arsimit (p.sh. shkolla e mesme apo arsimit universitar).

- Një hulumtim që do të fokusohet në vlerësimin e programeve të trajnimit për mësuesdhënësit, duke analizuar se cilat teknika dhe trajnime kanë ndikimin më të madh në përvetësimin dhe zbatimin e mësimit të diferencuar në klasë.
- Një studim që fokusohet te nxënësit me aftësi të kufizuara apo nevoja të tjera të veçanta dhe se si mësimi i diferencuar mund t'i ndihmojë ata të integrohen dhe t'i përmirësojnë rezultatet e tyre në mënyrë më efektive.


Në fakt, ky disertacion hap ide dhe mundësi të shumta për hulumtime të ardhshme që do të ndihmonin për ta thelluar kuptimin mbi rolin dhe efektivitetin e mësimit të diferencuar dhe do të ofronin udhëzime të vlefshme për përmirësimin e praktikave mësimore.

Vlerësim dhe propozim

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “*Ndikimi i zbatimit të mësimin të diferencuar tek suksesi i nxënësve në shkollën fillore*”, të kandidates Mr. sc. Digjle Namligji , konstaton se punimi në fjalë i plotëson të gjitha kushtet të parapara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve-studimet e doktoraturës në Universitetin e Tetovës dhe ka nderin që t’i propozoj Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Pedagogjik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof.dr. Lulzim Mehmedi (kryetar)
2. Prof.dr. Fadbi Osmani (anëtar)
3. Prof.dr. Besa Havziu Ismaili (anëtar)
4. Prof.dr. Valdeta Zenuni Idrizi (anëtar)
5. Prof.dr. Jehona Rushidi-Rexhepi (anëtar)



Tetovë, 23.09.2024